



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1674/9 prot.,

Datë 28.07.2025

V E N D I M
Nr. 965/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 918/2025, datë 16.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me Nipt. L82428011G dhe adresë Rruga “Njësia Administrative nr. 10, Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/1, Tiranë

Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me Nipt. K71903025A dhe adresë: Rruga “Gjin Bue Shpata”, Godina av. Vjeter, Hyrja 7, Ap. 34, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës.
Lagja Nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 16.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 918/2025, ku vendosi: [...]

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesë së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK. për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.*
3. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK. për procedurën e mësipërme të prokurimit*
4. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe ta ndajë atë në lote dhe të kryejë modifikimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
5. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
6. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.*
7. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Optima communication” SHPK.*
8. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
9. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

[...]”

I.3. Me shkresën nr. 2370 prot., datë 23.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1674/6 prot., datë 25.07.2025, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, informon se ka zbatuar vendimin Nr.918/2025, datë 16.07.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, duke anuluar procedurën e prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2370 prot., datë 23.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1674/6 prot., datë 25.07.2025, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 918/2025, datë 16.07.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, duke anuluar procedurën e prokurimit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme në përputhje me vendimin Nr. 918/2025, datë 16.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik por autoriteti kontraktor nuk i ka bashkëlidhur shkresës dokumentet e reja të tenderit të procedurave të prokurimit që do të rishpallë.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës nuk e ka zbatuar plotësisht vendimin Nr. 918/2025, datë 16.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, pasi nuk i ka bashkëlidhur shkresës dokumentet e reja të tenderit të procedurave të prokurimit që do të rishpallë.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.202021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurave të prokurimit që do të rishpallë të cilat duhet të jenë në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin nr. 918/2025 datë 16.07.2025 të KPP-së.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Florent Zguro

